



**Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**

# **PLANI VJETOR I PUNËS 2026**

**Tiranë, Dhjetor 2025**

# PLANI VJETOR I PUNËS 2026

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT DREJTORIA E MBIKËQYRJES

Nr.	Objektivat	Procedurat objekt i mbikëqyrjes dhe Subjekti i mbikëqyrjes	Arsyeja e mbikëqyrjes/inspektimit Përzgjedhja dhe risqet	Indikatorët e rezultateve	Njësia përgjegjëse	Koha e mbikëqyrjes / inspektimit e ndarë në 3-mujorë				Lloji i aktivitetit
						I	II	III	IV	
1.	<p>Mbikëqyrja e zbatimit të ligjshmërisë në shërbimin civil për procedurat e organizuara nga DAP në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore.</p> <p>Zbatimi i ligjshmërisë gjatë aplikimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve vakante.</p>	<p>Ky proces do të realizohet nëpërmjet mbledhjes së informacionit dhe ka për qëllim njohjen e situatës dhe evidentimin e problematikave, nëse ka, të cilat do të shërbejnë për të ndërhyrë më tej për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar në çdo fazë të procesit. Në këtë proces do të përfshihen të gjitha procedurat e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në institucionet</p>	<p>Gjatë procedurave që zhvillohen për plotësimin e pozicioneve të lira, pjesë e shërbimit civil, duhet të respektohen parimet e sanksionuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar, si parimi i shanseve të barabarta, emërimi në bazë të meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit, që sigurohen nëpërmjet një procesi përzgjedhës dhe transparent.</p> <p>Në këto rrethana, duke marrë parasysh rëndësinë e madhe të procesit,</p>	<p>Niveli i zbatimit të ligjit në trend rritës (<i>krahasimi i trendit do të bëhet me gjetjet e mëparshme të Komisionerit për subjektet e mbikëqyrura deri në finalizimin e setit të indikatorëve të përbashkët me DAP</i>).</p>	<p>Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit</p> <p>Drejtorja e Mbikëqyrjes</p> <p>Drejtorja e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ</p> <p>Fillimi i këtij procesi fillon me Vendim apo Urdhër të Komisionerit në fillimin të</p>	Po	Po	Po	Po	Mbikëqyrje e orientuar

		<p>që punësojnë nëpunës civilë, në administratën shtetërore</p> <p><u>Departamenti i Administratës Publike.</u></p>	<p>Komisioneri e ka përcaktuar si prioritet ndjekjen e tij nëpërmjet inspektorëve të ngarkuar për ta mbikëqyrur zhvillimin e tij përgjatë gjithë vitit kalendarik, sipas një metodologjie të përcaktuar në rregulloren e institucionit, në të gjitha subjektet që punësojnë nëpunës civilë, në administratën shtetërore.</p>		<p>vitit 2026.</p>					
2.	<p>Mbikëqyrja e zbatimit të ligjshmërisë në shërbimin civil.</p>	<p>Mbikëqyrje e orientuar lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institutet e ligjit të nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në: institucionet administratës shtetërore, institucionet e Vetëqeverisjes vendore në nivel qarku dhe institucionet e pavarura, për vitin 2026</p> <p>Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil do të vazhdojë monitorimin e vazhdueshëm të</p>	<p>Ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përfshirë të gjitha institutet e tij.</p> <p>Kjo mbikëqyrje do të shtrihet për gjithë periudhën e vitit 2026. Mbikëqyrja lidhur me monitorimin në kohë reale të administrimit të shërbimit civil, do të realizohet përmes monitorimit të vazhdueshëm dhe paralel të proceseve administrative që kryhen nga njësitë, nëpunësit e institucioneve në subjektet e përcaktuara në Urdhrin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Kjo</p>	<p>Niveli i zbatimit të ligjit nëpërmjet mbikëqyrjes në kohë reale.</p> <p>Informacioni i ardhur nga subjektet që përfshihen në fushën e veprimti të ligjit 152/2013, informacionet periodike të përpunuara nga inspektorët e Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ. Do të vizitohet/mbikëqyret/inspek</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit</p> <p>Drejtoria e Mbikëqyrjes</p> <p>Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ</p>	Po	Po	Po	Po	<p>Mbikëqyrje e orientuar</p>



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

	<p>zbatimit të të gjitha instituteve të ligjit nr. 152/2013 <i>“Për nëpunësin Civil”</i>, i ndryshuar, proces i cili do të mbikëqyr gjitha veprimet administrative që do të kryhen nga ana e Njësive Përgjegjëse atyre të Burimeve Njerzore si dhe të të gjithë nëpunësve të përfshirë në proceset e administrimit të shërbimit civil,</p> <p>Ky proces monitorimi do të realizohet nëpërmjet mbledhjes së informacionit në kohë reale dhe verifikimeve nëpërmjet raportimit periodik mujor të institucioneve të përfshira në këtë pikë, të administrimit të shërbimit civil, dhe ka për qëllim njohjen e situatës dhe evidentimin e problematikave, nëse ka, të cilat do të shërbejnë për të ndërhyrë më tej për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar në çdo fazë</p>	<p>formë/mënyrë mbikëqyrjeje ka për qëllim identifikimin në kohë reale të problematikave dhe risqeve procedurale, të cilat mund të shfaqen gjatë zhvillimit të proceseve dhe procedurave administrative, në kuadër të zbatimit të ligjshmërisë për administrimin e shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, <i>“Për nëpunësin civil”</i>, i ndryshuar. Mbikëqyrja do të ushtrohet nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të proceseve dhe procedurave administrative që kryhen nga Njësitë Përgjegjëse dhe strukturat e Burimeve Njerzore të institucioneve, të cilat punësojnë nëpunës civil, duke evidentuar në kohë reale çdo parregullsi ose risk potencial, i cili mund të çojë në paligjshmëri apo pavlefshmëri procedurale. Për këtë qëllim, inspektorët përkatës do të administrojnë dhe analizojnë aktet</p>	<p>tohet, çdo subjekt me qëllim verifikimin e të dhënave të raportuara për administrimin e shërbimit civil në bazë të sistemit të riskut.</p>						
--	---	--	---	--	--	--	--	--	--



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

		<p>të procesit. Po kështu të dhënat e mbledhura do të shërbejnë për planifikimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionerit për vitin pasardhës, duke përcaktuar nivelin e riskut dhe objektin e mbikëqyrjes. Detajet dhe tipologjia do të përcaktohen në urdhërine Komisionerit si dhe programin e punës në zbatim të këtij urdhëri.</p> <p><b>Të gjitha njësitë e qeverisjes Vendore</b></p> <p><b>61 Bashki</b> (të grupuara sipas qarqeve) <i>Përfshirë dhe 12 Këshillat e Qarqeve</i></p> <p><b>Qarku Tiranë:</b> <u>Këshilli i Qarkut Tiranë</u> <u>Bashkitë Tiranë, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë</u></p> <p><b>Qarku Durrës:</b> <u>Këshilli i Qarkut Durrës</u></p>	<p>administrative të nxjerra nga subjektet, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, do të mbajnë shënime të detajuara mbi veprimet dhe aktet administrative të ndjekura, si dhe do të jenë në komunikim të vazhdueshëm institucional me njësitë përgjegjëse dhe strukturat e burimeve njerëzore të institucioneve objekt mbikëqyrjeje.</p> <p><i>Raportimi do të kryhet nga inspektorët e Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ të ngarkuar sipas urdhrit të Komisionerit.</i></p> <p><i>Raportimi do të jetë mujor dhe në përmbledhje 3, 6, dhe 9 mujore dhe në përmbledhjen përfundimtare vjetore.</i></p> <p><i>Sipas problematikave të raportuara nga inspektorët përkatës, kur çmohet nga Komisioneri,</i></p>					
--	--	---	--	--	--	--	--	--



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

	<p><u>Bashkitë Durrës,</u> <u>Krujë, Shijak</u></p> <p><b>Qarku Fier:</b> <u>Këshilli i Qarkut Fier</u></p> <p><u>Bashkitë Fier, Lushnjë,</u> <u>Divjakë, Mallakastër,</u> <u>Patos, Roskovec</u></p> <p><b>Qarku Vlorë:</b> <u>Këshilli i Qarkut Vlorë</u></p> <p><u>Bashkitë Vlorë,</u> <u>Selenicë, Delvinë,</u> <u>Finiq, Himarë,</u> <u>Konispol, Sarandë</u></p> <p><b>Qarku Shkodër:</b> <u>Këshilli i Qarkut</u> <u>Shkodër</u></p> <p><u>Bashkitë Shkodër, Vau</u> <u>Dejës, Pukë, Malësi e</u> <u>Madhe, Fushë-Arrëz</u></p> <p><b>Qarku Berat:</b> <u>Këshilli i Qarkut Berat</u></p> <p><u>Bashkitë Berat,</u> <u>Kuçovë, Poliçan,</u> <u>Skrapar, Dimal</u></p> <p><b>Qarku Lezhë:</b> <u>Këshilli i Qarkut Lezhë</u></p> <p><u>Bashkitë Lezhë,</u></p>	<p><i>grupet e mbikëqyrjes mund të kryejnë mbikëqyrje në subjekt me qëllim verifikimin e situatës si dhe rregullimin e ligjshmërisë.</i></p> <p><i>Po kështu, inspektorët do të verifikojnë në subjekt vërtetësinë e të dhënave me qëllim publikimin e statistikave të sakta dhe pasqyrimin real të situatës.</i></p>							
--	--	---	--	--	--	--	--	--	--



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

	<p><u>Kurbin, Mirditë</u></p> <p><b>Qarku Dibër:</b> <u>Këshilli i Qarkut Dibër</u></p> <p><u>Bashkitë Dibër,</u> <u>Bulqizë, Klos, Mat</u></p> <p><b>Qarku Elbasan:</b> <u>Këshilli i Qarkut</u> <u>Elbasan</u></p> <p><u>Bashkitë Elbasan,</u> <u>Belsh, Cerrik, Gramsh,</u> <u>Librazhd, Peqin,</u> <u>Prrenjas</u></p> <p><b>Qarku Gjirokastrë:</b> <u>Këshilli i Qarkut</u> <u>Gjirokastrë</u></p> <p><u>Bashkitë Gjirokastrë,</u> <u>Dropull, Këlcyrë,</u> <u>Libohovë, Memaliaj,</u> <u>Përmet, Tepelenë</u></p> <p><b>Qarku Kukës:</b> <u>Këshilli i Qarkut</u> <u>Kukës</u></p> <p><u>Bashkitë Kukës, Has,</u> <u>Tropojë</u></p> <p><b>Qarku Korçë:</b> <u>Këshilli i Qarkut</u> <u>Korçë</u></p> <p><u>Bashkitë Korçë,</u></p>								
--	---	--	--	--	--	--	--	--	--

		<p><u>Devoll, Kolonjë,</u> <u>Maliq, Pogradec,</u> <u>Pustec</u></p> <p><b>Insitucionet e Administratës Shtetërore</b></p> <p><b>Insitucionet e Pavarura (Të listuara në Urdhërin përkatës të Komisionerit)</b></p>								
3.	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjshmërisë në shërbimin civil	<p>Mbikëqyrja/monitorim i i procedurave të plotësimit të vendeve të lira sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar.</p> <p>Ky proces do të realizohet nëpërmjet mbledhjes së informacionit dhe ka për qëllim njohjen e situatës dhe evidentimin e problematikave, nëse ka, të cilat do të shërbejnë për të ndërhyrë më tej për të rregulluar paligjshmërinë e</p>	<p>Gjatë procedurave që zhvillohen për plotësimin e pozicioneve të lira, pjesë e shërbimit civil, duhet të respektohen parimet e sanksionuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar, si parimi i shanseve të barabarta, emërimi në bazë të meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit, që sigurohen nëpërmjet një procesi përzgjedhës dhe transparent.</p> <p>Procedurat që do të mbikëqyren do të zgjidhen me sistem përzgjedhjeje duke e shpërndarë në kategori të ndryshme si dhe do të</p>	<p>Mbikëqyrja në këtë institucion është planifikuar me zgjedhje, mbi bazën e riskut.</p> <p>Procesi do të rregullohet me urdhër të veçante të Komisionerit</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit</p> <p>Drejtoria e Mbikëqyrjes</p> <p>Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ</p>	Po	Po	Po	Po	Mbikëqyrje tematike



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

		<p>konstatuar në çdo fazë të procesit.</p> <p>Në këtë proces do të përfshihen të gjitha procedurat e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në <b><u>Bashkinë Tiranë</u></b>.</p> <p>Do të përzgjidhen sipas rastit procedura konkurimi për pozicione të kategorive të ndryshme sipas grafikut/ informacionit të vazhdueshëm lidhur me këtë tematikë, bazuar në sistemin e riskut.</p> <p><b><u>Bashkia Tiranë</u></b>.</p>	shtrihet për gjatë gjithë vitit kalendarik.							
4.	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjshmërisë në shërbimin civil.	<p>Në këtë proces do të përfshihen aplikimi i nenit 65 “Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit”, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Mbikëqyrja do të ushtrohet në të gjitha institucionet e varësisë</p>	<p>Do të verifikohen procedurat e ndjekura nga Njësiti e Burimeve njerzore si dhe ajo përgjegjëse përkatësisht:</p> <p>“1. Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon për shkak të ligjit kur: a) nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij; b) nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i</p>	<p>Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë për zbatimin e institutit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil në kuptim të nenit 65, të ligjit si dhe akteve nënligjore në fuqi.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit</p> <p>Drejtoria e Mbikëqyrjes</p>	Po	Po			Mbikëqyrje tematike

		të Kryeministrisë dhe ministrive të linjës	<i>gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar; c) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë; ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit; d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale. 2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, konstatohet 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij nga: a) njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën; b) DAP-i për anëtarët e TND-së”.</i>							
5.	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjshmërisë në shërbimit civil.	Ky proces do të shtrihet për aktet e nxjerra gjatë vitit 2025 dhe do të përmbyllet gjatë 3 muorit të parë të vitit 2026, duke reflektuar, përmbledhur dhe analizuar të gjitha të dhënat e administruara nga subjektet të cilat kanë qenë të përfshira në planin e punës të vitit 2025 (Institucionet e Vetëqeverisjes	Ky proces do të shtrihet për gjithë vitin 2025, dhe do të kryhet duke përmbledhur dhe analizuar materialin e administruar nga subjektet e përfshira në urdhërin e Komisionerit.	Krahasimi i numrit të kërkesave ardhur në subjekt me procedurat e masave të nisura nga subjektet e mbikëqyrura.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit  Drejtoria e Mbikëqyrjes  Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ	Po				Mbikëqyrje e orientuar



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

		<p>vendore.</p> <p>Për vitin 2026 ky proces do të realizohet duke u fokusuar në zbatimin e institutit të disiplinës në shërbimin civil gjatë vitit 2025, sidomos në rastet e kërkesave/raportimeve të dërguara nga ana e subjekteve të kontrollit të brendshëm ose të jashtëm (<i>duke përfshirë në këtë grupim institucionet publike me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditi të jashtëm dhe të brendshëm, të parashikuara në ligje specifike</i>), të dërguara pranë subjekteve të kontrolluara, për të filluar ecuri disiplinore në ngarkim të punonjësve përgjegjës.</p> <p>Ky proces do të orientohet në këto drejtime:</p> <p>-për sa raste organi disiplinor, eprori direkt/komisioni disiplinor ka vendosur fillimin e procedimit disiplinor.</p>							
--	--	---	--	--	--	--	--	--	--



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

		<p>- në sa raste organi disiplinor ka vendosur mosfillim/pushim për çështjen apo dhe ka konkluduar me dhënien e masës disiplinore.</p> <p>Në rast konstatimi të parregullsive do të veprohet sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Në këtë proces do të përfshihen:</p> <p><b><u>Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore</u></b></p>								
6.	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e skemës së shërbimit civil.	Komisioneri do të vijojë procesin e mbikëqyrjes në institucionet e administratës vendore, që janë Këshillat e Qarqeve dhe Bashkia Kavajë, për të siguruar zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institutet e ligjit, për veprimet administrative të kryera gjatë vitit 2025. Institucionet që do të	Në këtë proces do të përfshihen verifikimi i të gjithë veprimtarisë administrative të subjekteve të listuara në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë të të inistuteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.	Verifikimi i ligjshmërisë së procedurave të zbatuara nga ana e Njërive përgjegjëse në zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit  Drejtoria e Mbikëqyrjes			Po	Po	Mbikëqyrje e Përgjithshme



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

		<p>përfshihen në mbikëqyrje janë:</p> <p><b>Këshilli i Qarkut Lezhë</b></p> <p><b>Kësulli i Qarkut Dibër</b></p> <p><b>Këshilli i Qarkut Berat</b></p> <p><b>Kësulli i Qarkut Durrës</b></p> <p><b>Këshilli i Qarkut Tiranë</b></p> <p><b>Këshilli i Qarkut Elbasan</b></p> <p><b>Këshilli i Qarkut Vlorë</b></p> <p><b>Këshilli i Qarkut Korçë</b></p> <p><b>Këshilli i Qarkut Gjirokastrë</b></p> <p><b>Këshilli i Qarkut Fier</b></p> <p><b>Këshilli i Qarkut Kukës</b></p> <p><b>Bashkia Kavajë</b></p>							
--	--	---	--	--	--	--	--	--	--



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

7.	Zbatimi i ligjit për shërbimin civil, në të gjitha institutet objekt mbikëqyrje sipas planit të punës.	Objekti i inspektimit dhe institucionet subjekt i këtij procesi janë përcaktuar në planin e punës, të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ.	Përfshirjen e inspektorëve të Drejtorisë së Mbikëqyrjes në inspektime sipas planit të punës.	Përcaktuar në pikat përkatëse të planit të punës.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit  Drejtoria e Mbikëqyrjes/ Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ	Po	Po	Po	Po	Inspektim
8.	Rritja e nivelit të zbatueshmërisë së ligjit	Takime pune dhe diskutime lidhur me problematikat që hasen në institucionet që janë pjesë e sistemit të shërbimit civil:  <u>Institucionet e Administratës Shtetërore</u>  <u>Njësitë përgjegjëse në Njësitë e Oeverisjes Vendore</u>  <u>Institucionet e Pavarura</u>	Nisur nga nevojat që do të evidentohen gjatë mbikëqyrjeve që do të zhvillohen ose nga kërkesat e institucioneve, sidomos në institucionet e vetëqeverisjes vendore, por edhe në institucionet e pavarura, mund të vlerësohet për tu kryer takime pune në ambjentet e Komisionerit si edhe në ambientet e subjekteve që janë pjesë e shërbimit civil, me pjesëmarrjen e stafit të Komisionerit dhe sipas një axhende të përcaktuar për çdo takim.		Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit përmes:  Drejtorisë së Mbikëqyrjes  Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ  Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit	Po	Po	Po	Po	Takime pune



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

9.	Të tjera	Në raste të caktuara Komisioneri mund të urdhërojë kryerjen e mbikëqyrjeve në subjekte të caktuara me kërkesë të vetë subjekteve, analizës së riskut të institucionit të KMSHC-së, problematikave që do të lidnin gjatë mbikëqyrjes së vazhdueshme në kohë reale të institucioneve, si dhe palëve të interesuara në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.	Në të gjitha insitucionet e administratës Shtetërore, ato të pavarur dhe njësitë e qeverisjes vendore.		Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit  Drejtoria e Mbikëqyrjes  Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ.	Po	Po	Po	Po	Tipologjia e mbikëqyrjes do të përcaktohet mbi bazën e problematikës që do të ndiqet.
----	----------	--	--	--	---	----	----	----	----	---



# PLANI VJETOR I PUNËS 2026

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr.	Objektivat	Procedurat objekt i inspektimit dhe Subjekti i inspektimit	Arsyeja e mbikëqyrjes / inspektimit Përzgjedhja dhe risqet	Indikatorët e rezultateve	Njësia përgjegjëse	Koha e mbikëqyrjes/inspektimit e ndarë në 3-mujorë				Lloji i aktivitetit
						I	II	III	IV	
1.	Verifikimi i ligjshmërisë së procedurave të ndjekura nga organet e ngarkuara nga ligji, gjatë aplikimit të instituteve të ligjit.	Në këtë proces do të përfshihet verifikimi paraprak i informacioneve që vijnë nga burime të ndryshme dhe sipas rastit do të fillojë proces i thelluar i hetimit administrativ. Në këtë proces përfshihen institucione të Administratës Shtetërore, Njësi të Vetqeverisjes Vendore dhe Institucione të pavarura.	Ndërhyrje e menjëhershme e Komisionerit, për të rregulluar ligjshmërinë me qëllim që institucioni t'i përgjigjet në kohë reale dinamikës së lartë të zhvillimeve në administratën publike.	Niveli i zbatimit të ligjit në trend rritës <i>(krahasimi i trendit do të bëhet me informacionet e mëparshme të ardhura pranë Komisionerit)</i>	Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes dhe Inspektimit  Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ	Po	Po	Po	Po	Verifikime / Inspektime / Hetim Administrativ
2.	Trajtimi, interpretimi dhe unifikimi i aspekteve të	Inspektimi/hetimi administrativ/kthim përgjigje, në lidhje me procedurat e	Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil do të përfshijë në këtë proces	Niveli i kuptimit të përmbajtjes së ligjit për	Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes dhe	Po	Po	Po	Po	Verifikime / Inspektime / Hetim Administrativ/

	ndryshme që evidentohen gjatë aplikimit në praktikë të instituteve të ligjit të shërbimit civil.	parashikuara, gjatë aplikimit të instituteve të legjislacionit të shërbimit civil, sipas kërkesave të ardhura nga ana e institucioneve të administratës shtetërore, njësi të vetqeverisjes vendore dhe institucione të pavarura, si dhe nga informacionet e administruara në rrugë të ndryshme të parashikuara në ligj apo rregulloren e procedurave të mbikëqyrjes/inspektimit.	raste të përsëritura dhe që paraqesin një problematikë të shtuar gjatë zbatimit të ligjit. Objekti i hetimit do të përfshijë të gjitha institutet e ligjit nr.152/2013, e shtrirë kjo, gjatë gjithë vitit, për të siguruar zbatimin e ligjit për shërbimin civil, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore, të përcaktuara.	shërbimin civil dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe njohja e zbatimit të procedurave të këtij ligji.	Inspektimit  Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ					unifikimi i procedurës/asis tencë teknike.
3.	Zbatimi i ligjit për shërbimin civil, në të gjitha institutet objekt mbikëqyrje sipas planit të punës.	Objekti i mbikëqyrjes/inspektimit dhe institucionet subjekt i këtij procesi janë përcaktuar në planin e punës, të Drejtorisë së Mbikëqyrjes.	Përfshirjen e inspektorëve të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ në mbikëqyrje sipas planit të punës.	Përcaktuar në pikat përkatëse të planit të punës.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit  Drejtoria e Mbikëqyrjes/ Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ	Po	Po	Po	Po	Mbikëqyrje

4.	Zbatimi i ligjshmërisë në procedurat e aplikimit të instituteve të ligjit të shërbimit civil.	Ky proces do të realizohet nëpërmjet inspektimit në subjekt, në përfundim të proceseve të parashikuara në legjislacionin e shërbimit civil, sipas informacioneve të ardhura pranë Komisionerit, nga subjekte të ndryshme.  Në njësi të vetqeverisjes vendore me shkelje të përsëritura të shërbimit civil.	Në mbështetje të informacioneve të ardhura pranë Komisionerit, ku ka dyshime të arsyeshme të shkeljes së legjislacionit të shërbimit civil, në bazë të riskut dhe shpeshtësisë së shkeljes së kryer, me urdhër të Komisionerit do të kryhen inspektime në subjekt.	Inspektimi në këtë institucion është planifikuar me zgjedhje, mbi bazën e riskut.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes dhe Inspektimit  Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ	Po	Po	Po	Po	Inspektim / Hetim Administrativ
5.	Sipas ngarkesës së punës dhe nevojave që dalin gjatë vitit në vijim, do të krijohen grupe të përbashkëta pune nga inspektorët e drejtorive në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme.				Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes dhe Inspektimit  Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ	Po	Po	Po	Po	Verifikime / Inspektime / Hetim Administrativ/ Mbrojtje
6.	Verifikimi i zbatimit të	Ky proces inspektimi do të realizohet nëpërmjet	Në vijim të procesit të inspektimit të kryer nga	Verifikimi i zbatimit të ligjit	Drejtoria e Përgjithshme e	Po	Po			Inspektim i thelluar



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

	<p>legjislacionit të shërbimit civil gjatë procesit të ndjekur për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë për periudhën Korrik-Dhjetor 2025</p>	<p>mbledhjes së informacionit dhe verifikimeve nëpërmjet kryerjes së inspektimit të thelluar në disa prej institucioneve të qeverisjes vendore. Ky proces ka për qëllim njohjen e situatës dhe evidentimin e problematikave, nëse ka, të cilat do të shërbejnë për të ndërhyrë më tej për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar në çdo fazë të procesit.</p> <p>Në 6 njësi të vetqeverisjes vendore, që janë:</p> <p>Bashkia Pogradec Këshilli Qarkut Lezhë Bashkia Gjirokastër Këshilli Qarkut Berat Bashkia Bulqizë Bashkia Përmet</p>	<p>grupet e punës të autorizuara nga Komisioneri, në institucionet e qeverisjes vendore, me objekt: Verifikimin e veprimeve të ndërmarra nga zyrtarët e ngarkuar nga ligji për hartimin e përkrahjeve të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, në kuadër të ndryshimeve strukturore të institucioneve.</p>	<p>në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me procedurën e hartimit dhe miratimit të akteve të përkrahjes të punës, për pozicionet e shërbimit civil, në këto institucione</p>	<p>Mbikëqyrjes dhe Inspektimit</p> <p>Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ</p>					
7.	Të tjera	<p>Në raste të caktuara Komisioneri mund të urdhërohen kryerjen e inspektimeve në subjekte të caktuara me kërkesë të vetë subjekteve, analizës së riskut të institucionit të KMSHC, si dhe</p>	<p>Në të gjitha institucionet e administratës publike.</p>		<p>Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit</p> <p>Drejtoria e Inspektimit</p>	Po	Po	Po	Po	<p>Sipas përcaktimit në Urdhërin përkatës të Komisionerit.</p>



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

		palëve të interesuara në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.			dhe Hetimit Administrativ					
--	--	---	--	--	---------------------------	--	--	--	--	--



# PLANI VJETOR I PUNËS 2026

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT DREJTORIA E ZBATIMIT TË VENDIMEVE PARALAJMËRUESE DHE KOORDINIMIT

Nr.	Objektivat	Procedurat objekt i mbikëqyrjes dhe Subjekti i mbikëqyrjes	Arsyeja e mbikëqyrjes/inspektimit Përzgjedhja dhe risqet	Indikatorët e rezultateve	Njësia përgjegjëse	Koha e mbikëqyrjes/inspektimit e ndarë në 3-mujorë				Lloji i aktivitetit
						I	II	III	IV	
1.	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e skemës së shërbimit civil.	Komisioneri do të vijojë procesin e mbikëqyrjes në të gjithë njësitë e qeverisjes vendore (bashki), nëpërmjet grupit të posaçëm që është <i>ngritur (i cili ndër të tjera edhe do të asistojë këto institucione)</i> për të siguruar zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e skemës së shërbimit civil.	Ky proces është parashikuar në planin vjetor të punës së Komisionerit, me bazë risku, në kushtet kur janë konstatuar në vijimësi probleme, si në lidhje me skemën e administrimit të shërbimit civil në institucionet e administratës vendore (ndërtimi i strukturës), ashtu edhe në lidhje me klasifikimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil (përshkrimet e punës).  Ky proces do të zhvillohet gjatë gjithë vitit dhe më tej, për sa do të nevojitet kohë për të zgjidhur këtë problem	Niveli i zbatimit të ligjit në trend rritës <i>(krahasimi i trendit do të bëhet me gjetjet e mëparshme të Komisionerit për subjektet e mbikëqyrura deri në finalizimin e setit të indikatorëve të përbashkët me DAP).</i>	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit  Drejtoria e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit  Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ  Drejtoria e Mbikëqyrjes	Po	Po	Po	Po	Mbikëqyrje e orientuar



## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

	<p>Gjatë këtij procesi do të analizohet struktura e çdo institucioni si nga pikëpamja e zbatimit të standardeve numerike të organizimit të njësive të strukturës (<i>Drejtori të përgjithshme, Drejtori dhe Sektorë</i>), ashtu edhe në drejtim të funksioneve që kryejnë pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjit për shërbimin civil në drejtim të klasifikimit dhe kategorizimit të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil.</p> <p><b>Të gjitha njësitë e</b></p>	<p>serioz dhe të mbartur në vite, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Ministrave; Kuvendin e Shqipërisë;</p> <p>Departamentin e Administratës Publike, njësitë përgjegjëse të administratës vendore; Kryetarin e Bashkisë; Këshillin Bashkiak; Prefekturat e Qarkut; Ministrinë e Brendshme; Agjencinë për Mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera që kanë lidhje me këtë proces.</p> <p>Ky proces do të vijë në ndihmë të këtyre institucioneve për të qartësuar në strukturën e tyre pozicionet e punës që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil, si dhe për të përfunduar procesin e hartimit të përshkrimit të punës, si një pikënisje e përcaktimit të detyrave konkrete për çdo pozicion dhe e përcaktimit të kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme që duhet të përmbushë një kandidat për t'u punësuar</p>						
--	--	---	--	--	--	--	--	--

